

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Pergjithshem, me gjyqtarin e vetëm gjykues Zyhdi Haziri, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale kundër të pandehurit F.M., për shkak të veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 paragrafi 1 nenparagrafi 1.4 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.1514/2017 të dt. 31.08. 2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 24.08.2018, mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri F.M. nga babai H., dhe nëna Z., i lindur me date ... ne fshatin ... me vendbanim ne Gjilan, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves, i papune, i martuar, baba i tre fëmijëve, më parë i dënuar.

ËSHTË FAJTORE

Sepse me date 17.08.2017 rreth orës 16:00 minuta, ne rrugën publike “ Isa Boletini” ne Gjilan- te qendra e penzionereve, i pandehuri F.M., lehte e lëndon tani te dëmtuarin R.Z. nga Gjilani, ne ate menyre qe per shkak te nje mosmarrëveshje te qastit qe i pandehuri kishte pasur me te dëmtuarin, per shkak se i dëmtuari nuk e pranonte rezultatin e humbjes se lojës ne shah dhe nga mllef i shkaktonte probleme ne lokalit e Qendres se Penzionereve, ndërsa ne ditën kritike i pandehuri me qellim qe te dëmtuarin ta largonte nga objekti i qendrës, ne nje moment e kap per krahu, e nxjerr nga objekti i qendrës dhe te shkallet e objektit e shtynë me duar, ku i dëmtuari rrezohet dhe pson lëndime te lehta trupore ne dorën dhe ne kemben e majte, i cili per shkak te lëndimeve te pësuar detyrohet qe te kërkoje ndihme mjeksore ne Emergjencen e Spitalit Regjional ne Gjilan.

-Me këtë ka kryer veprën penale, lëndim i lehte trupore nga neni 188 paragrafi 1 nenparagrafi 1.4 të KPRK-ës

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të nenit 4,41,42,45, 73 dhe 74 të KPRK-ës dhe neneve 248 dhe 365 të KPPRK-ës, të pandehurit i shqipton

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që te pandehurit F.M. i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (kater) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1 (nje) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Obligohet i pandehuri F.M. që në emër të mbrojtjes së viktimave të paguaj shumën prej 30 Euro pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paguajë paushallin gjyqësor në shumën pre 15 € (pesëmbëdhjet euro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti Departamenti I Pergjithshem, me datë 31.08.2017, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 1514/2017, kundër të pandehurit F.M., për shkak të veprës penale Lendim i lehte trupor nga neni 188 paragrafi 1 nenparagrafi 1.4 të KPRK-ës.

Kjo gjykatë me datë 18.01.2018 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori shtetit dhe i pandehuri, në të cilën seance i pandehuri pas leximit të aktaktakuzës nga ana e prokurorit ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues me datë 24.08.2018, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në të cilin kanë qenë prezent prokurori i shtetit, i pandehuri, ku pas dëgjimit të palëve si prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit me ç'rast gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të nenit 248 të KPPRK-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Në këtë aspekt gjyqtari ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmbën ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri ka kryer veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 paragrafi 1 nenparagrafi 1.4 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 248 të KPRK-ës, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit dhe të njejtit ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej prej 4 (kater) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1 (nje) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, ngase duke i marrë parsysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale.

Gjyqtari me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, se i njejtë është penduar dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale ndërsa rrethana rënduese gjykata mori faktin se natyra e këtyre veprave penale kohëve të fundit është e shprehur shumë në shoqërinë tonë.

5.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurës dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit duke i marr parasysh rrethanat e lartpërmendura është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë të pandehurit.

Gjyqtari po ashtu konsideron se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet apo dëmet e shkaktuara nga vepra penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ti paguajë shpenzimet procedurale sipas përlogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 15 € (pesembedhjet euro), në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dspozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Pergjithshem

Me datë 24.08.2018

Sekretarja Juridike

Fikrete Destani

Gjyqtari

Zyhdi Haziri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij akgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.